



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2002 / Prot.
3

Vlorë më. 24.12. 2021

VENDIM

Nr. 54, datë 22.12.2021

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT DERI NË MASËN 20% TË PROGRAMEVE
MËSIMORE PRANË FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE, PËR VITIN
AKADEMIK 2022-2023

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, nenit 38, pika 1 shkronja dh, nenit 75, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, pika 1, gërma ë, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si dhe Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", si dhe referuar shkresës nr. 1835/2 prot, datë 15.12.2021 të Zëvendësrektorit Akademik, Senati Akademik në mbledhjen e datës 22.12.2021

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shkencave Humane, për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20% si më poshtë:
 - Në programin e studimit "Master i Shkencave në Edukim", Departamenti i Edukimit -Ndryshon lënda EDU 580 "Teknologji Edukimi", nga lëndë Ndërdisciplinore/integruese (me zgjedhje) në Lëndë Karakterizuese e detyrueshme dhe bëhet nga 8 kredite në lëndë me 10 kredite. Lënda EDU 545 "Edukimi i të Drejtave të Njeriut në kurikulën parauniversitare" bëhet me 8 kredite nga 10 kredite dhe kalon në lëndë ndërdisciplinore/integruese.
 - Në programin e studimit "Master i Shkencave në Pedagogjinë e Specializuar", Departamenti i Edukimit:
 - a) lënda PS 440 "Aftësi e kufizuar mendore" - do të ndryshojë emërtimi i lëndës në "Çrregullime të inteligjencës" 10 kredite.
 - b) Lënda PS 480 "Vështirësitë në të nxëne dhe mësimëdhënia"- do të shtohet si lëndë e re karakterizuese me 7 kredite, në raportin 3/2 (3 leksione, 2 seminare/javë, 75 orë/semestër brenda auditorit = 175).
 - c) Lënda PS 450 "Menaxhim dhe Analizë Institucionale" - do të ndryshojë numri i krediteve, nga 10 kredite në 8 kredite, si dhe ndryshimin e raportit të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

orëve në auditor në 3/2 (3 leksione dhe 2 seminare/javë, 75 ore/semestër brenda auditorit dhe 125 ore/semestër jashtë auditorit, totali i orëve/semestër brenda dhe jashtë auditorit = 200).

d) Për lëndët me zgjedhje nga 10 kredite do të bëhen me 5 kredite, lëndet EDU 442 "Metodologji Mësimdhënieje" dhe PS 520 "Formimi i të rriturve", ndryshohet raporti i orëve të lëndës me zgjedhje në auditor në 2/1 (2 leksione dhe 1 seminare/javë, 45 orë/semestër brenda auditorit dhe 80 orë/semestër jashtë auditorit, totali i orëve/semestër brenda dhe jashtë auditorit = 125).

• Në programin e studimit "Master Profesional në Mësuesi për Arsimin fillor klasa IV", Departamenti i Edukimit:

- a) Lënda EDU 580 "Teknologji edukimi" ndryshohet nga lëndë Ndërdisciplinore/integruese me zgjedhje, në lëndë karakterizuese e detyrueshme dhe bëhet nga 8 kredite në lëndë me 10 kredite.
 - b) Lënda EDU 545 "Edukimi i të Drejtave të Njeriut" në kurikulën parauniversitare bëhet me 8 kredite nga 10 kredite.
2. Një kopje e këtij vendimi i përcillet MAS.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. As. Xhiliola AGARAJ

